

INFORMOHUNI

Sepse trafikimi i qenieve njerëzore është forma më e rëndë e dhunimit të të drejtave njerëzore. Fëmijët, gratë dhe vajzat janë grupet më të prekura nga ky fenomen.

INFORMOHUNI

Që të mos bini viktimë e abuzimit seksual, traumave mendore, ndarjes nga prindërit dhe familja, punës së detyruar, shfrytëzimit dhe të enurit një qytetar i dorës së dytë.

KUJDES!

Trafikantët mund të jenë dhe njerëz tek të cilët keni besim: shokë, miq, të afërm, nganjëherë prindi ose i fejuari që ofron martesa të rreme, bashkime familjare, studime dhe punë jashtë ose brenda vendit. Mund të detyroheni të veproni jashtë vullnetit tuaj dhe në kushtet e lirisë së kufizuar.

INFORMOHUNI MBI MIGRACIONIN E RREGULLT DHE KUJDES NGA TRAFIKIMI I QENIEVE NJERËZORE!

TRAFIKIMI EKZISTON ENDE!

Kërkon informacion në të gjitha burimet e mundshme. Sigurohuni që po bëni zgjedhjen më të mirë për të migruar!

NESE VENDOSNI TË MIGRONI
INFORMOHUNI MBI RREGULLAT E VENDEVE PRITËSE
ZGJIDHNI RRUGËN MË TË SIGURT!



Për më shumë informacion, ju lutem kontaktoni:

Zyrën e Organizatës Ndërkombëtare për Migracionin (IOM)
Rruga "Brigada e Tetë", Vila nr.3, Tiranë
Tel: + 355 4 257 836/7/271 629
Fax: + 355 4 257 835
E-mail: iomtirana@iomtirana.org.al

Qendrën e Shërbimeve për Migrantët (IOM-MSC)
Tel & Fax: 355 4 271 628

vizitoni:
www.iomtirana.org.al
www.migrantinfonet.com

British Embassy
Tirana



**MIGRACIONI
I RREGULLT
ËSHTË ZGJEDHJE
DHE MUNDËSI**

Të gjithë kemi të drejtën të migrojmë, pasi ekzistojnë mundësi të ndryshme për të kërkuar një jetë më të mirë, një pune, për studime apo turizëm. Por shpesh ndodh të na ofrohen mundësi jo të rregullta që të çojnë në zgjedhje të gabuara, ndërsa në fakt ka

MUNDËSI MIGRACIONI TË RREGULLT.

Nëse dëshironi të migroni në vendet e BE-së, Kanada-së, SHBA-së, Australi-së duke bërë zgjedhjen e duhur...

ÇFARË MUND TË BËNI?

PAJISUNI ME DOKUMENTAT E DUHURA:

Për të hyrë në vendin ku dëshironi, ju nevojitet një pasaportë e pajisur me vizë dhe dokumenta të tjera udhëtimit, lëshuara nga ambasada ose konsullata përkatëse.

Zakonisht ka lloje të ndryshme vizash dhe dokumentash në varësi të qëllimit të migracionit.

KONTAKTONI

Zyrat e Punësimit Rajonal, Qendrën e Shërbimeve për Migrantët të IOM, ose shërbimet konsullore respektive dhe kërkoni informacion për:

PUNËSIM

Informohuni mbi mundësitë e punësimit të rregullt në këto vende. Nëse ju ofrohet një kontratë për të punuar jashtë, përpipuni ta konfirmoni atë dhe të kuptoni kushtet. Kini parasysh se për të punuar jashtë ju nevojitet një leje pune në vendin pritës.

STUDIME:

Kontaktoni zyrat konsullore të ambasadave përkatëse, për të marrë informacion mbi mënyrat e aplikimit për të fituar të drejtën e studimit apo bursë, duke kontaktuar universitetet dhe kolegjet, flisni me shokë ose me ish-studentë.

VIZITA TURISTIKE:

Merrni informacion mbi procedurat dhe dokumentat që duhet të paraqisni. Kontrolloni kush do paguajë për udhëtimin në rast se nuk paguani vetë dhe mos harroni që diçka mund të fshihet pas saj.

BASHKIME FAMILJARE:

Informohuni mbi të drejtat tuaja si familjar dhe çfarë kushtesh duhet të plotësoni që të përfiton bashkimin me pjesën tjetër të familjes që ndodhet në vendin pritës, sepse vende të ndryshme kanë legjislacione të ndryshme. Këshillohuni gjatë përgatitjes së dokumentacionit për këtë procedurë. Shpesh hasen probleme në përgatitjen e tij. Kjo bën që aplikimi të fillojë nga e para.

MUNGESA E KËTIJ INFORMACIONI:

MUND të bëjë që trafikantët e vizave të pasurohen me paratë tuaja, duke ju mashtruar, kështu mund të gjendeni para një realiteti krejt ndryshe nga ai që dëshironi.

MUND të gjendeni pa dokumenta të rregullta në vendin ku shkoni dhe të mos pranoheni aty.

MUND të mos keni të drejtë të përfiton nga shërbimet elementare, arsimi dhe mundësítë për punësim në vendin ku do të shkoni.

MUND të gjendeni të izoluar nga të afërmit e miqtë, të cilët nuk do të mund t'ju ndihmojnë.

MUND të përfundoni në viktimë të shfrytëzimit për prostitucion, ose forma të tjera të shfrytëzimit seksual. Kjo mund t'ju çojë në kriminalitet, punë të detyruar, sklavëri ose praktika të ngjashme, deri në përdorimin e organeve.

MUND të rrezikoni jetën duke provuar kalime të parregullta të kufirit me skafe ose në zona të rrezikshme.

INFORMOHUNI

Për mundësitë e migracionit për punësim, studim dhe bashkim familjar në vende të tjera, që të ndjeheni të sigurtë për hapin që ndërmerrni.

INFORMOHUNI

Që të mos dëmtoheni nga ana financiare, të kursemi kohën, mundin dhe zhgënjimin e pashmangshëm.

INFORMOHUNI

Sepse vetëm kështu mund të migroni me dinjitet, të qetë dhe të sigurtë drejt qëllimit tuaj duke evituar rreziqet.